




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Programi Komunal Tre Vjeçar për Banim 2020-2022



Dhjetor, 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2020-2022

ZYRA E KRYETARIT TE KOMUNËS

VENDIMI: 01-112/02-39983 të datës 25.10.2019

**GRUPI PUNUES - KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR
BANIM:**

EMRI DHE MBIEMRI	DREJTORIA	PËRGJEGJËSIA
BLERTA QELA	PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE	KRYESUES
HYRMETE BEJTULLAHU	PËR PUNË TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE	ANËTARE
MIRLINDA MULLAHASANI	PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	ANËTARE
GEZIM BAKIJA	PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	ANËTAR
ARBEN HULAJ	PER SHËNDETËSI	ANËTAR
SHKURTA BERISHA KRASNIQI	KABINETI I KRYETARIT	ANËTARE

Ndihma për këtë program është dhënë nga organizata Developing Together në kuadër të projektit “Rritja e kapaciteteve dhe vetëdijes lidhur me të drejtën për banim” në kuadër të programit Angazhimi për Barazi - E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID Kosovo dhe zbatuar nga Advocacy Training and Resource Center – ATRC



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	6
1.1	VIZIONI	6
1.2	QËLLIMI I PROGRAMIT	7
1.3	OBJEKTIVAT	7
2	KORNIZA LIGJORE	8
2.1	DOKUMENTET TJERA RELEVANTE	9
3	PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	10
4	VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT	11
5	STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR.....	12
6	PROFILI I KOMUNËS SË GJAKOVËS.....	13
6.1	POZITA GJEOGRAFIKE.....	13
6.2	KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE	13
6.3	LËVIZJA E POPULLSISË	14
6.4	MIGRIMI.....	15
7	ARSIMI	16
7.1	BANIMI	17
7.1.1	PLANI GJENERAL URBAN VITI 1989.....	18
7.1.2	FAKTORËT THEMELOR PËR KËRKESAT PËR BANIM.....	18
7.1.3	PERIUDHA E PAS LUFTËS	18
8	ANALIZË EKONOMIKE.....	20
8.1	BUJQËSA	20
8.2	TURIZMI	21
8.3	ZONA EKONOMIKE AMERIKANE	22
8.4	POTENCIALI PËR ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME	22
8.5	TË ARDHURAT.....	22



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



8.6	PAPUNËSIA	23
9	EKONOMIA/ POTENCIALI I KOMUNES	24
10	PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA	25
11	ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL	28
11.1	OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL	28
11.2	KOMPLEKSI I BANIMIT NË LAGJEN “ALI IBRA”	30
11.3	PLANI RREGULLUES TË DARDANIA LINDORE (TE BUNARËT) – LOKACION I RREGULLUAR ME BANIM INDIVIDUAL	32
11.4	FAMILJET MOMENTALISHT TË NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL	33
11.4.1	PLANI RREGULLUES URBAN “TIRANA”	33
11.5	KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL	36
11.6	KATEGORITË E SYNUARA.....	36
11.7	KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË	37
11.8	GJENDJA FAKTIKE.....	37
12	PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL	40
12.1	SIGURIMI I BANIMIT PËR 113 FAMILJE	40
12.2	BONUS BANIMI.....	46
12.2.1	MËNYRA E IMPLEMENTIMIT.....	46
13	PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT	47
14	ANALIZA E FAKTEVE - PËRMBLEDHJE	48
15	REZULTATET PAS ZBATIMIT	52
16	SEKTORIT I BANIMIT.....	53
16.1	INSTRUMENTET E MBIKËQYRJES	54
17	ANALIZA SWOT.....	55
18	PËRFUNDIM	56
19	REFERENCAT	57



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1, ARSIMI.....	16
FIGURA 2, ZONA EKONOMIKE AMERIKANE	22
FIGURA 3, OBJEKTET E BANIMIT SOCIAL	29
FIGURA 4, SITUACIONI I DY NDËRTESAVE EKZISTUESE PËR BANIM SOCIALË	30
FIGURA 5, KOMPLEKSI ALI IBRA, OBJEKTET E BANIMIT TE NDËRTUARA PËR MINORITETE(RAE).....	31
FIGURA 6, LAGJJA "ALI IBRA".....	32
FIGURA 7, BANIMI SOCIAL PER MINORITETE DARDANIA	33
FIGURA 8, LOKACIONI I PUNUAR NGA DUMM.	41
FIGURA 9, PERSPEKTIVAT E OBJEKTEVE TË BANIMIT SOCIAL.....	42
FIGURA 10, REVIDIMI I PLANIT RREGULLUES I KOMPLEKSIT ‘ALI IBRA’	43
FIGURA 11, KATI KARAKTERISTIK I OBJEKTIT KOLEKTIV TË BANIMIT SOCIAL	44
FIGURA 12, VENDIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS MBI MIRATIMIN E LOKACIONIT PËR BANIM SOCIAL.....	45
Figura 13, SWOT ANALIZA	55

LISTA E TABLEAVE

TABELA 1, PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	10
TABELA 2, DEMOGRAFIA E KOMUNËS SE GJAKOVËS	14
TABELA 3, GRUPMOSHAT NË KOMUNËN E GJAKOVËS (3)	14
TABELA 4, GJENDJA SOCIALE	22
TABELA 5, TË DHËNA MBI PAPUNËSINË NË KATËR(4) VITET E FUNDIT	23
TABELA 6, BURIMET E FINANCIMIT.....	24
TABELA 7, LISTA E PLANEVE RREGULLUESE	27
TABELA 8, LISTA E PËRFITUESVE TË BANESAVE SOCIALE NË RRUGËN TIRANA.....	34
TABELA 9, FAMILJET MOMENTALISHT TË NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL	35
TABELA 10, GJENDJA FAKTIKE E GJAKOVËS.....	39
TABELA 11, BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR BANIM SOCIAL PËR VITET 2019- 2021	47



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



1 HYRJE

E drejta për banim është njëra ndër të drejtat fundamentale të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga aspekti social, banimi adekuat është një e drejtë themelore e njeriut ndërsa nga aspekti i planifikimit hapësinor/urban, banimi konsiderohet si shfrytëzues më i madhi i hapësirës. Si çështje sociale dhe çështje e planifikimit strategjik të një vendi, adresimi i çështjes së banimit në mënyrë të duhur siguron zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst qasja në banim është një disiplinë multisektoriale, mjaft komplekse që kërkon nga autoritetet qendrore dhe komunale përkushtim dhe vullnet politik për të adresuar me kompetencë këtë çështje.

Me miratimin e “Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit” i është dhënë një kornizë më e avancuar autoriteteve vendim marrëse lokale për të ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Kosovës.

Sigurimi i Banimit është bazë për funksionalizimin e familjes, shoqërisë por edhe vet shtetit, si për nga stabilitet psiko-social ashtu edhe ekonomik. Andaj me këtë program, pretendojmë që të vendosim rregullsi në adresimin e çështjeve të banimit në komunë, për të ofruar banim me qira jo profitabile për kategoritë e popullatës që nuk kanë fuqi ekonomike për të paguar qira në tregun e lirë të banesave.

1.1 VIZIONI

Komuna e Gjakovës me një infrastrukturë të ndërtimit dhe banimit social, e integruar në rrjedhat e zhvillimit evropian, e përgatitur të përballët me sfidat e kohës. Qytet model, i cili me ndryshimin esencial të kushteve ekzistuese bazuar në prioritetin e veçantë në politikat zhvillimore të Komunës drejt arritjes së kualitetit të lartë të jetës, për të gjitha strukturat e banimit.



1.2 QËLLIMI I PROGRAMIT

Synimi i këtij programi është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim, për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

1.3 OBJEKTIVAT

Objektiv i gjithmbarshëm i komunës së Gjakovës, është që përmes këtij programi të bëjë përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës në përgjithësi, që rezulton në reduktimin e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit, duke:

- ✓ Identifikuar pasqyrën reale të problemeve në komunën e Gjakovës, që kanë të bëjnë me çështjen e banimit;
- ✓ Zhvilluar politika adekuate përfshirë specifikat lokale, veçoritë gjeografike, demografike dhe institucionale për zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim, për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike për të siguruar banim me çmime të tregut;
- ✓ Krijuar kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit dhe
- ✓ Gjetjen e mënyrave të financimit për realizimin e zbatimit të Programit Trevjeçar të Banimit.



2 KORNIZA LIGJORE

Programi Tre-Vjeçar për Banim është bazuar në legjislaturën si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-164, dt.04.2010 për financimin e programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira jo profitabile, Nr.10/2010 dt.2.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e bonusit të banimit, Nr.19/2010-dt.02.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, Nr.22/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për normat e banimit për programet e veçanta të banimit, Nr.24/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit, Nr.23/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Nr.21/2010, dt. 18.11.2010;
- Ligji 04/L-134 të ndërtesës në bashkëpronësi, dt.06.09.2013;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dt.19.06.2008;
- Ligji nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dt.27.01.2012;
- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;
- Statuti i Komunës;
- Dokumentet planore – urbane;
- Ligji për Procedurat Administrative, 05/L-031, dt.21.06.2017.

Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Komunale Tre Vjeçare të Banimit, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 “Për financimin e Programeve të Veçanta të Banimit” dhe njëkohësisht i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik që nënkupton dhënien e përgjigjes në pyetjet:

- ku jemi? që i referohet analizës së gjendjes ekzistuese;
- ku do të shkojmë? Synimet;



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



- si të arrijmë atje? objektivat, veprimet, projektet etj.;
- si të bindemi se kemi mbërri? monitorimi dhe vlerësimi.

Dokumenti është hartuar nga grupi punues komunal në mbështetje të *Development Together* dhe *MMPH* dhe tenton të përshkruaj një rrjedhë logjike të banimit që nga themelimi i qytetit , gjendjen ekzistuese dhe projeksionet e zhvillimit të banimit në vitet në vijim.

2.1 DOKUMENTET TJERA RELEVANTE

- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;
- Plani Zhvillimor Komunal (2006 – 2015 +);
- Plani Zhvillimor Urban (2006 – 2015 +);
- Plani Rregullues Urban i rrugës “Tirana” ;
- Banesat n pronësi të Komunës:
 - Zona Kadastrale(Z.K.), Gjakove Jashte Qytet (Banesa 7 dhe 8) Orize Rr.”Aleksander Mojsiu”;
 - Z.k. Gjakovë Qytet (Banesa në rrugë të Dibranëve) Rr.”Mbretëresha Teuta”;
 - Z.k. Gjakove Jashtë Qytet (Banesa e Bardhe) Rr.”Ferid Domi”;
 - Z.k. Gjakovë Jashtë Qytet (Banesa me kulm te gjelbërt) Rr.”Ferid Domi”.
- Plani Rregullues “Ali Ibra” – dy lokacione të rregulluara me banim individual;
- Revidim i Planit Rregullues Urban “Ali Ibra” – ky lokacion është plotësuar me dy objekte për banim kolektiv (me Vendim të Kuvendit Komunal);
- Plani rregullues te Dardania Lindore (te bunarët) – lokacion i rregulluar me banim individual;
- Ligji për procedurat e përgjithshme administrative 05/L-031.



3 PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT




TABELA 1, PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT



4 VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT

Vendimet shitesë për përpilim të Programit Trevjeçar për Banim janë si në vijim:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës me datë 25.10.2019, për përgatitjen e Projektit të Programit të Veçantë për Banim në Komunën e Gjakovës për Periudhën 2020-2022;
- Sigurimi i të dhënave nga fushat përkatëse të Komunës (Drejtorja e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Zyra për Komunitete, Qendra për Punësim etj.);
- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë (UA Nr.21/2010) për gjendjen faktike të çështjes së banimit;
- Përgatitja e dokumentit;
- Bërja publike e PTB (Programit Trevjeçar të Banimit) – informimi;
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës.

Në përpilim të programit ka ndihmuar edhe OJQ Developing Together .



5 STRATEGJITË E NIVELIT QEVERTAR

- Plani Komunal i Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Problemit 2016-2018;
- Plani i Veprimit për Riatdhesim;
- Planin Lokal të Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian 2018-2022;
- Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Romë dhe Ashkali ne Shoqëri 2017-2021 nga niveli Qendror;
- Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018-2020;
- Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018-2022.



6 PROFILI I KOMUNËS SË GJAKOVËS

Komuna e Gjakovës është zhvilluar gjatë shekujve XIV – XV rreth Xhamisë së Hadumit, e cila ishte ndërtuar në shekullin XVI. Qyteti i Gjakovës kishte një tregti të pasur dhe ishte qendër e punës së dorës. Ky qytet ka një histori të lashtë, të cilën e simbolizojnë edhe monumentet historike dhe fetare, ka numër të konsiderueshëm të liqeneve dhe lumenjve, Urave si dhe së fundmi Shpellave.



FIGURE 1, URA E TERZIVE

6.1 POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Gjakovës shtrihet në zonën jugperëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, në pjesën midis qytetit të Prizrenit dhe qytetit të Pejës. Radhitet në vendin e tretë për nga sipërfaqja 586.62 km².

Shquhet me tokë pjellore që shtrihet përgjatë hapësirës tektonike të Rrafshit të Dukagjinit e i cili gjendet në mes të Bjeshkëve të Nemuna, Pashtrikut, Mokrrës së Gorës dhe Sharrit, në lartësi nga 360m. deri në mbi 2650m mbi nivelin e detit.




FIGURE 2, KOMUNA E GJAKOVËS

6.2 KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE

Komuna e Gjakovës ka 94,556 banorë (sipas censurit të fundit të vitit 2011), ndërsa nën moshën 18 vjeçare është 35,753 e popullsisë së Gjakovës. Shtimin më të madh natyror në rajonin perëndim e ka Komuna e Gjakovës me 912 banorë, të dhëna këto bazuar në statistikat e vlerësimit të popullsisë për vitin 2017. (1)



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



	TOTAL	FEMRA	MESHKUJ
RURAL	53,729	26,736	26,993
URBAN	40,827	20,594	20,233
POPULLESIA	94,556	47,330	47,226
88 FSHATRA	11 FSHATRA ZONË NDËRKUFITARE ME SHQIPËRINË		

TABELA 2, DEMOGRAFIA E KOMUNËS SE GJAKOVËS

6.3 LËVIZJA E POPULLSISË

Përveç etnitetit Shqiptar numri i të cilëve supozohet të jenë 87.672 banorë në Komunën e Gjakovës jetojnë edhe 17 banorë Serb, 73 banorë Boshnjak, 13 banorë Goran, 738 banorë Romë, 16 banorë Turq, 613 banorë Ashkalinjë, 5117 banorë Egjiptian dhe 297 banorë të tjerë. (2)

0-9			15-29			30-49		
M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
13,291	12,222	25,513	14,097	12,690	26,786	11,705	12,734	24,439

TABELA 3, GRUPMOSHAT NË KOMUNËN E GJAKOVËS (3)

50-64			65-84			>85			TOTAL
M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	GRUPMOSHAT GJITHSEJ
5,423	6,112	11,535	2,988	3,751	6,739	147	229	377	95,388

TABELA 4, GRUPMOSHAT NË KOMUNËN E GJAKOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



6.4 MIGRIMI

Sipas raportit të fundit të Agjensionit të Statistikave të Kosovës, Komuna e Gjakovës ka 1,722 numrin e popullsisë të cilët jetojnë jashtë vendit. Emigrimi më i madh jashtë vendit, ka ndodhur gjatë viteve 1998-1999 gjatë luftës në Kosovë. Është një fakt që të gjithë e dimë.



7 ARSIMI

Komuna e Gjakovës njihet si vatër e arsimit, në Komunën e Gjakovës janë 7 shkolla të mesme dhe 50 shkolla fillore.

Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë vitet e fundit ka pësuar rënie, në vitin shkollor 2014/2015 në klasën e parë janë regjistruar 1395 nxënës ndërsa në vitin shkollor 2018/2019 në klasën e parë janë regjistruar 1248 nxënës.

Komuna e Gjakovës ka plan zhvillimor të arsimit 2017-2021.




FIGURA 1, ARSIMI

Në Komunën e Gjakovës është themeluar edhe Këshilli Konsultativ në arsim i cili ka karakter dhënien e këshillave, ideve dhe konsultave për përmirësimin e cilësisë së arsimit i cili është formuar nga Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini nga njerëz të dëshmuar në lëmin e arsimit.

Përbëhet nga veteran të arsimit, shoqëria civile dhe përfaqësues të gjitha partive politike, në mënyrë që arsimi i Komunës së Gjakovës të jetë sa më transparent.

“Nëse mundesh m'e paramendu, mundesh m'e kriju!” – BONEVET



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në Komunën e Gjakovës kemi hapësira të ndryshme për përgatitje profesionale, e cila mbështetë të rinjtë në përgatitjen dhe orientimin e tyre për të bërë zgjedhjen dhe hapat e duhur drejtë zhvillimit të një karriere të suksesshme.

QENDRA PËR AFTËSIM PROFESIONAL (QAP) - Në këtë qendër bëhet aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbime për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit.

BONEVET MAKERSPACE - Qëllimi i qendrës Makerspace është të inkurajojë individë të talentuar me ide për të marrë iniciativa, për të mësuar dhe për të krijuar. Kjo qendër lehtëson procesin e transferimit të teknologjisë në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Rrjedhimisht, forcon bashkëpunimin midis anëtarëve të Makerspace dhe partnerëve të ndryshëm, të cilët mbështesin pjesëmarrjen në projekte të ndryshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

JAKOVA INOVATION CENTER - Kjo qendër shërben si inkubator biznesi me një mision të promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrësve të rinjë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompanive të reja. Pra, misioni i inkubatorit është mbështetja për kompanitë e reja dhe sigurimi i hapësirave inovative që punojnë me akses 7/24. Gjithashtu ofron këshillime mbështetëse, programe trajnimi në fusha të tilla si: Menaxhimi i Biznesit, Hulumtimi i Tregut, Financimi, Marketingu dhe shumë fusha të tjera të cilat janë të rëndësishme në bërjen e biznesit.

QENDRA PËR KARRIERË NË SHKOLLËN E MESME TEKNIKE "NEXHMEDIN NIXHA" - Kjo qendër ndihmon nxënësit e kësaj shkolle por edhe të rinjtë tjerë të Komunës së Gjakovës, që në të ardhmen të ngrisin vetëdijen duke marrë vendimet e duhura për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre.

7.1 BANIMI

Duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës si aktiviteti themelor i vendbanimeve, banimi ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të shoqërisë dhe është komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik-social, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi. Zona urbane e qytetit të Gjakovës karakterizohet me



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 161 banorësh/ km^2 a. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për zonat urbane.

7.1.1 PLANI GJENERAL URBAN VITI 1989

Është përgatitur në harmoni me kërkesat e kohës kur edhe është projektuar. Me këtë plan, hapësirat urbane janë të definuar me shumë precizitet dhe pjesërisht të pandryshueshme. Zhvillimin e Komunës ky plan e parasheh në sistemin mjaft të qëlluar policentrik, të ndarë në Qendra Sekondare dhe Qendra të Bashkësisë së Fshatrave, ku zonat e dendësisë së ndryshme ndërtimore përreth qendrës dhe pjesës së vjetër të qytetit. Disa pjesë të këtij plani janë realizuar. Megjithatë, pas 20 vitesh gjendja ekonomiko-politike dhe sociale në Komunën e Gjakovës ka ndryshuar rrënjësisht, dhe shumë pjesë të PGJU janë të tejkaluara. Disa vendbanime janë rritur në mënyrë jo formale dhe ndërtimi i disa rrugëve të planifikuara nuk ka mundur të realizohen. Prandaj problematika e banimit zë vend të posaçëm në planet në vijim për zhvillimet e ardhshme të zonës urbane.

7.1.2 FAKTORËT THEMELOR PËR KËRKESAT PËR BANIM

Rritja e popullsisë dhe të amvisërive si dhe ndryshimet në strukturat e tyre si ngritja të fuqisë ekonomike të Gjakovës kushtëzon nevojën e ndërtimit të një numri të madh të banesave, si dhe ndryshimin e mënyrës dhe standardit jetësor. Kjo nga ana tjetër kushtëzon nevojën e organizimit të hapësirës adekuatë e cila kërkohet nga planet urbane, përparimi i strukturës së hapësirës si dhe zgjedhja më e mirë e terreneve të parapara për ndërtim banesor.

7.1.3 PERIUDHA E PAS LUFTËS

Gjatë luftës të vitit 1999, Gjakova ishte një nga qytetet më të dëmtuara të Kosovës. Shumë ndërtesa në qendrën historike, duke e përfshirë edhe pazarin, ishin djegur në tërësi. Shumica e ndërtesave të shkatërruara janë ndërtuar dhe riparuar.

Aktivitetet për riparim dhe rikonstruktiv të shtëpive të shkatërruara gjatë luftës (EU/IMG 1999/2000) filluan menjëherë pas mbarimit të saj. Numri i shtëpive të ndërtuara pas luftës dokumenton aftësitë e njerëzve dhe familjeve në Gjakovë t'i përballojnë kushtet e vështira ekonomike dhe të kenë sukses në krijimin e shtëpive të reja për nevoja të veta në numër të



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



cilin asnjë qeveri shtetërore nuk kishte qenë në gjendje ta krijojë në kohë dhe numër të njëjtë. Kualiteti i ndërtimeve sigurisht se nuk i ka plotësuar në të gjitha rastet standardet teknike për shkak të vet ndërtimit dhe mungesës së ndihmës profesionale. Edhe një problem tjetër ka qenë mungesa e standardeve të planifikimit urban, sidomos menjëherë pas luftës, rregullat e planifikimit nuk janë respektuar ose ndërtimet janë bërë në zonat ku nuk ka pas plan rregullues dhe në të cilat nuk ka pas mundësi të epet Leja për Ndërtim. Në fshatrat ku shtëpitë individuale janë forma më e përhapur e banesave, zonat për ndërtime të reja munden lehtë të përgatiten përbrenda strukturës ekzistuese të vendbanimeve ose në periferi.

Në qytet nevojitet llojllojshmëri e ndërtesave të banimit. Një pjesë e familjeve mund të ndërtojnë shtëpitë e tyre individuale , por ka nevojë edhe për banesa kolektive, me qira ose me bashkëpronësi, sidomos për familje të vogla të cilat nuk janë në gjendje të ndërtojnë shtëpitë e tyre.

Theksohet nevoja e ndërtimit të banesave sociale për persona pa kulm mbi kokë, nevojë për të cilën komuna duhet t'i jep prioritet të veçantë si në politikat zhvillimore të komunës ashtu edhe në gjetjen e formës së financimit dhe realizimit.



8 ANALIZË EKONOMIKE

Gjakova qysh nga e kaluara ka traditë shekullore të veprimtarive ekonomike. Është shumë e pasur me burime natyrore, toka pjellore, kushte të përshtatshme atmosferike dhe pozitë të mirë gjeografike. Komuna e Gjakovës është e pasur edhe me krom (Cr). Aktualisht në Komunën e Gjakovës ushtrohen veprimtari të ndryshme të prodhimit, duke pasur gjithnjë potencial të vazhdueshëm për zgjerim në sektorin e Bujqësisë, Turizmit, Tregtisë, Energjisë së Ripërtrishme, Riciklimit të Mbeturinave, Prodhimit të Tekstilit dhe të gjitha llojet e veprimtarive të cilat mund të përdorin të gjitha potencialet të cilat i ka komuna. Ka numër të konsiderueshëm të bizneseve aktive rreth 3,400, disa nga bizneset e Gjakovës eksportojnë në vendet e huaja duke pasur qasje të lehtë në vendet Evropiane.

Komuna e Gjakovës ofron edhe Infrastrukturë rrugore të shtruar rreth 90%. Kufizohet me 11 Fshatra ndërkufitare me Shqipërinë dhe ka qasje shumë të shpejtë përmes tri Pikave Kufitare me Shqipërinë:

- Qafa e Prushit në jug 12.3 KM
- Qafa e Morinës në perëndim 22.4 KM
- Prizren 37 KM

Duke e marrë parasysh fuqinë punëtore në dispozicion, Komuna e Gjakovës ka kuadro të përgatitura për tregun e punës, respektivisht kuadro të arsimuara në Shëndetësi, Ekonomi, Administrim Biznesi, Hoteleri, Juridik si dhe në fushat e tjera përmes të cilave Gjakova, do të rrisë aftësitë konkurruese, nivelin e arsimit si dhe aspektet e tjera. Përveç grup moshave të kualifikuara të cilët janë në kërkim të punës, Gjakova po ashtu ka një numër të madh të inxhinierëve të mekanikës, elektronikës, ndërtimtarisë, arkitekturës, teknologjisë ushqimore, kimisë, si dhe ekspertë në industrinë e prodhimit të tekstilit, agrikulturës, zejtarisë, tregtisë etj.

8.1 BUJQËSA

Komuna e Gjakovës shquhet me tokë të punueshme e shumë pjellore. Nisur nga këta faktor dhe nga kushtet e përshtatshme klimatike, bujqësia përfaqëson një potencial të madh zhvillimi për ekonominë e komunës. Bujqësia e Komunës së Gjakovës ka një



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



perspektivë të madhe për zhvillim, duke pasur për bazë sistemin e ujitjes si dhe traditën e popullatës që merret me bujqësi. Mundësi të ri funksionimit ka edhe industria ushqimore e cila ka vepruar në të kaluarën. Në zonat rurale bujqësia është 70% si burim i jetesës, duke theksuar se Komuna e Gjakovës ka numrin më të madh të fshatrave më gjithsej 88 në nivel të Kosovës. Përqindja e tokës sipas kualitetit të saj është: Tokë e mirë: Klasa I, II, III 40%; Tokë e mesme: Klasa IV, V 20%; Tokë e varfër: Klasa V, VI 40%;

8.2 TURIZMI

Qyteti përmban një sërë monumentesh nga e kaluara e pasur kulturore. Gjakova ka numër të konsiderueshëm të liqeneve dhe lumenjëve si: *Liqeni i Radoniqit, Lumi Erenik, Lumi i Drinit të Bardhë, Lumi Krena, Lumi Trava dhe Llukaci*, dhe Urave si: *Tërziqe, Tabakëve, Taliqit dhe Ura e Fshajtë*. Degët e turizmit të identifikuar janë turizmi malor (*Maja e Kunorës, Shpellat e Kusarëve*) dhe turizmi kulturor.

Pjesa më atraktive dhe më e vizituar e Gjakovës është Çarshia e Madhe, e cila është ndër çarshitë më të mëdha të rajonit me një shtrirje mbi 34.000 m² dhe me mbi 500 dyqane, në të cilën përveç zanateve të vjetra mund të gjinden edhe dyqane nga fusha e hotelërisë dhe turizmit. Në komunën e Gjakovës aktualisht gjenden 4 muze: *Muzeu Historik, Muzeu Etnografik, Muzeu i Muzikës dhe Muzeu i Familjes Qerkezi nga lufta e vitit 1999*, duke mos lënë anash as numrin e madh të shtëpive të vjetra tradicionale dhe urave.

Poashtu, Gjakova është e pasur me një numër të madh të objekteve të vjetra të kultit. Ndër to veçohen: *Xhamia e Hadumit, Xhamia e Mahmut Pashës, Xhamia e Kusarëve, Kisha e Shën Palit dhe e Shën Pjetrit, Kisha e Shën Ndout, Kisha e Becit, Teqja e Madhe Autoqefale, Teqja e Shejh Eminut, Teqja e Bektashinjëve*. Ndërsa si pjesë e trashëgimisë natyrore janë: *Kodra e Çabratit, Parku i mbrojtur Shkugëza, Liqeni i Radoniqit, Kanioni i Drinit të Bardhë, Shpella e Kusarëve*.



8.3 ZONA EKONOMIKE AMERIKANE



FIGURA 2, ZONA EKONOMIKE
AMERIKANE

Në vitin 2018 në Komunën e Gjakovës është themeluar Parku Industrial në Gjakovë, “Zona Ekonomike Amerikane”. Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën dhe ka ndarë buxhet për ndërtimin e Infrastrukturës, meqë komuna ia ka ofruar tokën me sipërfaqe 486.6655 HA, e shtrirë në magjistralen Gjakovë – Prishtinë. Kjo zonë, përveç që ka pozitë të mirë gjeografike, do të ketë edhe ndikim shumë të madh në zhvillimin Ekonomik të Gjakovës e cila ka për synim tërheqjen e investitorëve dhe bizneseve Amerikane me qëllim të plasimit të produkteve apo shërbimeve të tyre në tregun Evropian.

8.4 POTENCIALI PËR ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME

Gjakova ka potencial për të investuar në sektorin e energjisë. Në nivel të Kosovës, Gjakova ka temperaturat më të larta , e cila 278 ditë në vit është nën rrezet e diellit. Ofron kushte atmosferike pa mjegull dhe dukshmëri të theksuar. Komuna e Gjakovës posedon edhe Toka jobujqësore prej 40%, të cilat mund të përdoren për potencial të Investimeve në sektorin e Prodhimit të Energjisë.

8.5 TË ARDHURAT

Gjendja Sociale e të ardhurave mesatare të, Komunës së Gjakovës

Vitet	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve
2016	1.045	4.349
2017	983	4.013
2018	969	3.976
2019	985	4.071

TABELA 4, GJENDJA SOCIALE



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO**
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



8.6 PAPUNËSIA

VITI	2016	2017	2018	2019
PUNË KËRKUES TË REGJISTRUAR	4476	4746	5431	5482
MESHKUJ	2565	2576	3053	3082
FEMRA	1911	2170	2378	2400
PA SHKOLLË	3%	3%	2.5%	
ME SHKOLLË FILLORE	29%	29%	31%	
MESME	46%	46%	46%	
FAKULTET	22%	22%	20.5%	
MASTER	0.4%	0.4%	0.3%	
RURAL	52%	52.4%	51.5%	
URBAN	48%	47.6%	48.5%	
MOSHA 15-24	16%	16%	16%	
MOSHA 25-39	42%	42%	42%	
MOSHA 40-54	30%	30%	30%	
MOSHA 55+	12%	12%	12%	
ROMË, ASHKALI, EGJIPTIAN	8.4%	0.4	8.40%	
BOSHNJAK	0.4%	0.4	0.40%	
PROFILET E KËRKUARA NË TREG PUNE	HOTELIERI , RROBAQEPËSI, NDËRTIMTARIA , SHITËSE , FLOKTARI ETJ.	HOTELIERI , RROBAQEPËSI, NDËRTIMTARIA , SHITËSE, FLOKTARI, PARUKERI ETJ.	HOTELIERI , RROBAQEPËSI, NDËRTIMTARIA , SHITËSE, FLOKTARI, PARUKERI ETJ.	
REFERIMET NË QAP , VETPUNËSIME	1430	1540	1620	
PUNË KËRKUES TË TRANSFERUAR	92	17	24	
MATP -TR. NË PUNË, SUBVENCION,INTERSHI P, PUNË PUBLIKE ETJ	201	193	146	
NDËRMJETËSIMET E RREGULLTA	381	268	459	

TABELA 5, TË DHËNA MBI PAPUNËSINË NË KATËR(4) VITET E FUNDIT



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



9 EKONOMIA/POTENCIALI I KOMUNES

Burimet e Financimit te komunës se Gjakovës 2019-2021

Burimet e Financimit	2018	2019	2020	2021
	Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1. Granti i përgjithshëm	9.168.618.00	9.061.498.00	9.874.142.00	10.508.815.00
2. Granti për arsim	8.032.644.00	9.124.587.00	9.166.885.00	9.209.400.00
3. Granti për shëndetësi	2.576.012.00	2.836.680.00	2.978.514.00	3.127.440.00
4. Gjithsej HVK	3.141.143.00	3.495.017.00	3.615.535.00	3.736.052.00
5. Financim nga huamarrja	348.185.00	267.391.00		
Totali	23.266.602.00	24.785.173.00	25.635.076.00	26.581.707.00

TABELA 6, BURIMET E FINANCIMIT



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



10 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA

Nr.	Zonat- territori i mbuluar me plane urbane	Sipërfaqja	Vendimet e Miratuara në Asamblenë Komunale
1	Plani zhvillimor Urban dhe Komunal	587.6 km ²	01Nr.011-3856/2008
2	Modifikimi I Planit Urbanistik "Gjakova 2005"	4.50 ha.	01 Nr.011-6903/2008
3	Plani Rregullues Urban, "Tirana"	40.00 ha.	01 Nr. 464-23845/2007
4	"Plani Rregullues Urban, "UÇK-Sadik Stavileci"	2.10 ha.	01 Nr. 464-23845/2007
5	Plani Rregullues Urban, "Mbretëresha Teutë"	10.00 ha.	01 Nr. 464-23845/2007
6	Plani Rregullues Urban, vendbanimi joformal "Brekoc"	18.80 ha.	01 Nr. 464-23845/2007
7	Plani Rregullues Urban, "Dardania Perëndimore"	60.00 ha.	01 Nr. 011-3428/2008
8	Plani Rregullues Urban, "Ura e Islam Beut - Gjykata Komunale"	7.0 ha.	01 Nr. 4011-2126/2019
9	Plani Rregullues Urban, "Zona e spitalit"	2.15 ha.	01 Nr. 011-4123/2009
10	Plani Rregullues Urban "Jugu 1"	10.00 ha.	01 Nr. 011-3417/2010
11	Plani Rregullues Urban, vendbanimi joformal "Kolonja"	3.85 ha.	01 Nr. 011-3785/2010
12	Plani Rregullues Urban, Xheladin Hana, Vashingtoni dhe "Hysni Dobruna"	6.0 ha.	01 Nr. 011-3785/2010
13	Plani Rregullues Urban, "Jugu 2" (Mustafa Bakija)	6.5 ha.	01 Nr. 011-2920/2011
14	Revidimi I Planit Urbanistik "Orize 1-8"	4.0 ha.	01 Nr.011-6529/2011
15	Plani rregullues Urban "Kompleksi Urbanistik I potezit përgjatë rrugës regjionale Gjakovë Prizren - ana jugore"	7.5 ha.	01 Nr.011-2025/2012
16	Plani Rregullues Urban "Parku I Qytetit dhe segmenti perëndimor I rrugës Tirana"	11.2 ha.	01Nr.011-5052/2012
17	Planit Rregullues Urban "Jugu" potezi në mes të rrugëve "Skënderbeu", "Musa Zajmi" dhe "Naum Veqilharxhi" dhe "Jugu A" potezi në mes të rrugëve "Skënderbeu", "Sadedin Shehu" dhe "Ali Pash Tepelena" dhe Jugu ana lindore	13.00 ha.	01 Nr.011-3709/13



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



18	Planit Rregullues Urban "Qarshia e Vogël – ana perëndimore" potezi në mes të rrugëve "Skënderbeu", "Abedin Tërbeshi", "Lumi Krena" dhe "Xheladin Hana".	4.5 ha.	01 Nr.011-4606/2013
19	Plani Rregullues I Hollësishëm për zonën pejsazh I mbrojtur "Shkugza"	90.00 ha.	01Nr.011-4538/2014
20	Plani Rregullues I Hollësishëm Fehmi Agani, Sadik Stavileci, Tivari	11.00 ha.	01 Nr.011-78407/2015
21	Plani rregullues I hollësishëm qendra sekundare Rogovë	1539.22 ha.	01 Nr.011-11177/2016
22	Plani Rregullues I Hollësishëm Dëshmorët e Lirisë ana lindore dhe perëndimore	15.80 ha.	01 Nr. 011-51040/2016
22	Plani rregullues I hollësishëm Kompleksi Urbanistik "REZINË DHE PETRO NINI LUARASI"	272.00 ha.	01 Nr.011/01-5061
PLANET URBANISTIKE IDEORE DHE DETALE TË MIRATUARA NË PERIUDHËN E PARA LUFTËS			
1	Plani Urbanistik(ndërrimi destinimit) miniblloku "Orize"	2.5 ha.	01 Nr. 011-3786/2010
2	Vendimi mbi Planin e detal të megakompleksit "Ali Pashë Tepelena" (është miratuar nga Këshilli I Ekspertëve)"	2.0 ha.	
3	Vendimi mbi Planin ideor të "Veriu"(revidim)	12.8 ha.	
4	Vendimi mbi Planin e detal të "Jugu B"	1.7 ha.	"Sesioni I VII I Asamblesë Komunale në
5	Vendimi mbi Planin detal të qendrës së ngusht të qytetit segmenti Nëna Terezë - Mazllom Lakuci	3.0 ha.	Gjakovë me datë 14.03.2001"
6	Vendimi mbi Planin detal të qendrës së ngusht të qytetit segmenti "Nëna Terezë- Mazllom Lakuci- Abedin Tërbeshi"	3.0 ha.	"Sesioni I VII I Asamblesë Komunale në
	Gjithsejt	2156.22 ha.	Gjakovë me datë 14.03.2001"
PLANET IDEORE DHE DETALE TË APLIKUESHME TË PERIUDHËS SË PARA LUFTËS.			



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



1	Vendimi mbi Planin e rregullacionit të Qarshisë së Madhe	22.00 ha.	G.Z. KSAK nr.25/82
2	Vendimi mbi Planin e detal të "Orize Jugore dhe orize"	90.00 ha.	G.Z. KSAK nr.23/76
3	Vendimi mbi Planin e detal të "Orize lindore"	12.00 ha.	"Vendimi I Këshillit Ekzekutiv të"
4	Vendimi mbi Planin detal të segmenti "Mulliri I Gutave"	15.00 ha.	
5	Vendimi mbi Planin detal të segmenti "Elasti I vjetër"	9.0 ha.	
6	Vendimi mbi Planin ideorë të potezit "Teflon 2"	2.0 ha.	
7	Vendimi mbi Planin ideorë të potezit "Cara potok 1"	3.0 ha.	
8	Vendimi mbi Planin ideorë të potezit "Cara potok 2"	2.0 ha.	"Vendimi I Këshillit Ekzekutiv të"
9	Vendimi mbi Planin ideorë të potezit "Cara potok 3"	5.0 ha.	Komunës me numër 01-350-18 datë 04.11.1997"
10	Vendimi mbi Planin detal të Parkut Memorial "Çabratë"	60.0 ha.	"Vendimi I Këshillit Ekzekutiv të"
11	Piskot Dardani Lindore	84.0 ha.	Komunës me numër 01-06-25 datë 02.02.1998"
12	Zona industriale	104.38 ha.	
13	Blloqet e vjetra urbane Stacion deri ne Trakaniq nga veterina	24.2 ha.	
14	Blloqet e vjetra urbane -senjaku	14.00 ha.	
15	Blloku Sh.mesme deri tek policia e re	27.5 ha.	
	Planet Urbanistike për 23 vendbanime të Komunës së Gjakovës (Meqë, Skivjan, Bec, Doblibare, Berdosane, Damjan, Lipovec, Novosellë e epërme, Smaq, Kodrali e Becit, Marmull, Zhdrell, Ujz, Trakaniq, Osek Pashë,Qerim, Lugbunar, Rogovë, Bishtazhin, Cërmijan,Janosh dhe Novosellë e poshtme)	//	
	Gjithsej:	474.08ha	474.08 ha.

TABELA 7, LISTA E PLANEVE RREGULLUESE



11 ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL

Ne Komunën e Gjakovës në dy objektet e banimit kolektiv në pronësi të komunës të cilat janë të dedikuara për banim social , në të njëjtat gjithësej janë sistemuar 48 familje të ndihmuara me sigurim të banimit.

Kërkesat zyrtare aktuale për banim në Komunën e Gjakovës gjithësej janë 24, duke mos përfshirë kërkesat jo zyrtare të cilat janë të shumta. Ndërsa kërkesat për pagës të qeras së banimit gjithësej janë 18.

11.1 OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

Ne komunën e Gjakovës ekzistojnë dy objektet e banimit kolektiv në pronësi të komunës të cilat janë të dedikuara për banim social që gjenden në rrugën “Tirana”. Në këto dy ndërtesa për banim social ekzistojnë 48 njësi banesore në të cilën jetojnë 211 banorë.

Këto objekte janë ndërtuar me marrëveshje në mes të nivelit qendror dhe komunal të pajisura me Leje Ndërtimore: Nr. 07/351-17144 dt.05.10.2006 njëri objekt dhe tjetri Nr. 07/351-5988 dt.23.10.2009



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



FIGURA 3, OBJKTET E BANIMIT SOCIAL




FIGURA 4, SITUACIONI I DY NDËRTESAVE EKZISTUESE PËR BANIM SOCIALE

11.2 KOMPLEKSI I BANIMIT NË LAGJEN “ALI IBRA”

Në lagjen “Ali Ibra” ekziston edhe Kompleksi i banesave i ndërtuar për komunitete Romë, Ashkali dhe Egjptas të cilat janë veçse të sistemuara.

Lista e përfituesve të shtëpive në kompleksin “Ali Ibra”

Në vitet 2010-2015 kanë përfituar gjithsej 142 familje, në ndërtim të shtëpive me fonde te Caritasit Zvicerian si donator kryesor. Ka pasur edhe fonde tjera të vogla nga Ministria për Komunitete dhe kthim, Zyra për çështje të komuniteteve si dhe ADA -Agjencia Austriake për Zhvillim. Vlera totale ka qenë mbi 3.5 milion €.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



FIGURA 5, KOMPLEKSI ALI IBRA, OBJEKTET E BANIMIT TE NDËRTUARA PËR MINORITETE(RAE)

Kriteret në bazë të cilave janë zgjedhur familjet përfituese janë:

1. Familjet që kanë qenë në lagje që nga data 04 Prilli 2008, kur është dorëzuar lista e familjeve pranë komunës së Gjakovës, kanë jetuar aty dhe kanë qenë dakord për t'u dislokuar në lagje të re,
2. Familjet që kanë qenë në lagje që nga Prilli 2008 deri në shkurt 2010, kanë qenë nga Komuna e Gjakovës, kanë jetuar aty dhe kanë qenë dakord për t'u dislokuar në lagje të re.



FIGURA 6, LAGJJA "ALI IBRA"

11.3 PLANI RREGULLUES TË DARDANIA LINDORE (TE BUNARËT) – LOKACION I RREGULLUAR ME BANIM INDIVIDUAL

Nga ky kompleks i rezervuar për banim social në pronësi të Kuvendit Komunal, janë ndërtuar gjithsej gjashtë (6) Objekte të banimit individual të ndertuara në varg.

Objektet janë ndërtuar nga Fondacioni Hollandez në bashkpunim me kuvendin komunal Gjakovë, dhe sistemimi i familjeve është realizuar nga Komuna.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në këtë kompleks janë të planifikuara për ndertim edhe 11 shtëpi të banimit individual me etazhitet P+0



FIGURA 7, BANIMI SOCIAL PER MINORITETE DARDANIA

11.4 FAMILJET MOMENTALISHT TË NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL

11.4.1 PLANI RREGULLUES URBAN "TIRANA"

Në lagjen Tirana gjenden dy objekte të ndërtuara dhe planifikohen të ndërtohen edhe dy objekte të reja, me etazhitet P+4.

Nga ky kompleks i rezervuar për banim social në pronësi të Kuvendit Komunal, janë ndërtuar dy objekte kolektive të banimit. Lista e përfituesve të njësive banesore në këto dy objekte është gjithsej 48 familje me 211 banorë.

Propozojmë të bëhet rivlerësimi i këtyre 48 familjeve brenda 6 muajve nga aprovimi i këtij programi gjithashtu të kërkohen fonde për renovim të këtyre objekteve.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



GJENDJA AKTUALE SA FAMILJE JANE DUKE U NDIHMUAR	GJITHSEJ	2009	2010	2011	2016	2019
FAMILJE PA KONTRATA	3	19	2	1	19	4
NUMRI I FAMILJEVE TË VENDOSURA	48					
FAMILJE TË DESHMOREVE	8					
PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA	3					
INVALID I LUFTËS	1					
PENSION INVALIDOR	2					
PENSION I VETERANIT	1					
PENSIONERE	1					
RAST SOCIAL	1					
VETERAN I LUFTËS	2					

TABELA 8, LISTA E PËRFITUESVE TË BANESAVE SOCIALE NË RRUGËN TIRANA

Komuna e Gjakovës në raste emergjent përkrah edhe familjet që janë pa strehë duke i ndihmuar me pagesë të qirasë brenda vitit kalendarik me 600 €.

Për pagesë të qirasë gjatë vitit 2019 janë bërë 18 kërkesa dhe pas verifikimit kanë përfituar 5 familje.

Mënyra e ndihmës	Nr. i familjeve të ndihmuar	Nr. i individëve të ndihmuar	Data e fillimit të ndihmës	Data e skadimit të ndihmës	Vlera e qirasë/ndihma financiare (€)
1 Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;	48	211	2009	Pas tre viteve	0



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



2	Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;	5	19	2019	6 muaj prej vitit kalendarik	100
3	Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim;	/	/	/	/	/
4	Shtëpi individuale të ndërtuara nga donatorë të huaj/vullnetarë;	Kolonia: 142 familje, Dardania 6 familje.				
5	Renovime/riparime					

TABELA 9, FAMILJET MOMENTALISHT TË NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL



11.5 KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL

Për momentin në Komunën e Gjakovës janë paraqitur 24 raste për t'u ndihmuar me banim social. Komuna i posedon informatat e këtyre familjeve dhe do të merren parasysh për tu ndihmuar përmes këtij programi i cili pritet që të miratohet nga Asambleja Komunale e Gjakovës. Numri i kërkesave për banim social llogaritet të jetë shumë më i madh.

Sidoqoftë, këto 24 raste por edhe rastet tjera të cilat mund të paraqiten do ti nënshtrohen procesit të vlerësimit përmes kriterëve të përcaktuara me ligj.

11.6 KATEGORITË E SYNUARA

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë: karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen :

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
- Të kthyerit dhe komunitetet RAE (Minoritetet)
- Të riatdhesuarit
- Të moshuarit
- Të rinjtë
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror
- Nën vetushqyese-kryefamiljare



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



11.7 KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave;
- Gjendja shëndetësore;
- Invaliditeti;
- Struktura e familjes;

11.8 GJENDJA FAKTIKE

KOMUNA E GJAKOVËS			
Nr. i popullsisë		94,556	
Zonat rurale		53.729	
Zonat urbane		40.827	
Nr. i fshatrave/nr i lagjeve		88/11	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999	/	
	Nr. objekteve pas 1999		
	Etazhiteti mesatar		
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	/
		Nj. banimi	/
	Pas 1999	Nr. objekteve	/
		Nj. banimi	/
	Etazhiteti mesatar		
Statusi pronësor [banim kolektiv) para 1999		Privat [nj. banimi]	/
		Shoqëror [nj. banimi]	/
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]		/	
Kryje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]		~ 90%	
Nr. i objekteve të pabanuara		/	
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim		61 objekte në Komunën e Gjakovës	



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]		/
Ndërtimet ilegale	mbindërtimet	
	ndërtimet tjera	Të evidentuara 8500 në v.2014
	ndërtimet në pronë shoqërore	
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit		Aktuale me kërkesë zyrtare 24
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		• Revidim i Planit Rregullues Urban “Ali Ibra” – ky lokacion është plotësuar me dy objekte për banim kolektiv të përealizuara me 28 njësi banimi • Plani Rregullues Urban i rrugës “Tirana” – ky lokacion ka edhe dy objekte për banim kolektiv të përealizuara. • Plani Rregullues Urban vendbanimi joformal “Kolonia” – ky lokacion ka edhe 18 shtëpi të përealizuara. • Plani rregullues të Dardania Lindore (te bunarët – ky lokacion ka edhe 11 shtëpi të përealizuara.
Nr. i objekteve/nj. banimi të ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët		Plani Rregullues Urban i rrugës “Tirana” – dy banesa me 48 njësi. Banesa 7 dhe 8 Orize, Rr.”Aleksander Mojsiu” me 56 njësi; Banesa në rrugë të Dibraneve, Rr.”Mbreteresha Teuta” me 26 njësi; Banesa e Bardhe, Rr.”Ferid Domi” me 40 njësi; Banesa me kulm të gjelbërt, Rr.”Ferid Domi” me 30 njësi. Plani Rregullues Urban vendbanimi joformal “Kolonia”– 142 shtëpi nga komunitetet ROMË, ASHKALI dhe EGJIPTIAN, prej tyre 116 shtëpi të ndërtuara nga CARITASI Zvicëran, Ministria për Kthim dhe Komunitete MKK, Agjensia Austriake ADA, Zyra për Qështje të Komuniteteve. Ndërsa 26 shtëpi të ndërtuara për persona të zhvendosur nga komunitetet ROMË, ASHKALI dhe EGJIPTIAN janë ndërtuar nga UNHCR, IOM, Fondet e BE-së dhe



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



		MKK, ADA. Plani rregullues te Dardania Lindore (të bunarët) 6 shtëpi. Plani rregullues te Dardania Lindore janë ndërtuar 6 shtëpi për komunitetin shqiptar përmes donacionit HOLANDEZ. Donacionet për ndërtimin e shtëpive në prona private: Me fonde të OJQ VORAE (voice of Roma, Ashkalia and Egyptians) dhe Komunës së Gjakovës janë ndërtuar 7 shtëpi dhe 11 renovime dhe anekse të ndërtimit për komunitetet ROMË, ASHKALI dhe EGJIPTIAN. Me fonde të BE-së të implementuara nga IOM-i janë ndërtuar gjithsej 12 shtëpi. Për personat e zhvendosur nga Mali i Zi për komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian.
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlere mes. e qirasë		/
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponushëm për qira të ulëta të tregut		/
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që mund të adaptohen		/
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	6 objekte kolektive të banimit social (prej tyre dy të realizuara)
	Vendndodhja /emërtimi	Plani Rregullues Urban i rrugës "Tirana" – me katër objekte të planifikuara, prej të cilit dy janë të realizuara. Vendndodhja në rrugën "Tirana";
	Nr. i familjeve	48
	Nr. i banorëve	211
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		Janë bërë 6 lokacione – Plane Rregulluese. Për të ardhmen është problem çështja e pronës – ka mangësi të tokës në pronësi Komunale.

TABELA 10, GJENDJA FAKTIKE E GJAKOVËS



12 PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim i Komunës së Gjakovës është hartuar për periudhën 2020-2021. Komisioni i formuar nga ana e kryetarit të komunës me ndihmën e OJQ Developing Together ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e Komunës së Gjakovës që nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë. Për përpilimin e këtij programi janë marr parasysh edhe mundësitë buxhetore, informatat lidhur me karakteristikat e Komunës së Gjakovës, mundësitë reale për ndihmë sipas ligjit për financimin e programeve të veçanta për banim (03L-164).

Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare do të vazhdohet me analiza për të krijuar sektorin e banimit në kuadër të Komunës së Gjakovës i cili i mungon komunës sonë.

Pra, Programi i prezantuar Tre-Vjeçar për Banim i ka dy objektiva:

1. Sigurimin e banimit për 113 familje;
2. Formimin e sektorit për banim;

12.1 SIGURIMI I BANIMIT PËR 113 FAMILJE

Brenda viteve 2020-2022 do të ndihmohen 113 familje sipas dy skemave

1. Ndërtesave për banim social
2. Përmes skemës së bonus banimit

Në vijim do të përshkruhet mënyra se si planifikohet që të ndihmohen familjet përmes ndërtesave për banim social.

- a. Dy objektet ekzistuese në kompleksin Tirana – 48 Familje

Komuna e Gjakovës do të vazhdoj t'i ndihmoj 48 familje në dy ndërtesa ekzistuese të banimit social në lagjen "Tirana".



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Brenda vitit 2020 duhet të bëhet verifikimi i statusit të banimit për të gjitha familjet. Kjo do të bëhet përmes një procesi transparent ku do të ftohen të gjitha 48 familjet që t'i plotësojnë formularët dhe përmes një komisioni komunal të krijuar për këtë qëllim do të verifikohen të gjitha rastet sipas ligjit dhe udhëzimeve administrative në fuqi. Familjet të cilat i plotësojnë kriteret do të vazhdojnë të qëndrojnë në këto banesa. Me këto familje do të nënshkruhet kontratë DY VJEÇARE ku do të specifikohen kushtet e qëndrimit. Pas kësaj periudhe familjet do të duhet të ri-aplikojnë për të qëndruar në këto banesa sociale.

Në këtë proces do të ftohet shoqëria civile e sidomos OJQ profesionale që të ndihmojnë, siç është OJQ developing Together e cila ka ndihmuar në përpilimin e draftit të këtij programi.

b. Ndërtimi i dy objekteve të reja në lagjen "Tirana" – 60 njësi banimi

Sipas Planit Rregullues Urban rruga "Tirana", planifikohet që në afërsi të 2 ndërtesave ekzistuese për banim social në lagjen "Tirana", të ndërtohen edhe 2 objekte të banimit kolektiv me dimensione 22.30 / 15.75 me etazhitet P+4+NK.

Këto dy objekte kanë së bashku gjithsej sipërfaqe prej $S=4216 \text{ m}^2$, të zhvilluara me 60 njësi banimi, ku çmimi total për të dy objektet është ~1.127.862 € .




FIGURA 8, LOKACIONI I PUNUAR NGA DUMM.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



FIGURA 9, PERSPEKTIVAT E OBJEKTEVE TË BANIMIT SOCIAL

Komuna e Gjakovës do të participon me 20 % të vlerës, ndërsa nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të kërkohet vlera tjetër prej 80 %.

Përzgjedhja e këtyre familjeve do të bëhet përmes një procesi transparent dhe sipas ligjit. Këto banesa sociale do të shfrytëzohen për familjet në gjendje të rëndë socio-ekonomike që nuk mund të sigurojnë vet – banimin; për nënat vet – ushqyese; për viktimat e dhunës në familje si dhe për familjet që mund të mbesin pa banim, si pasojë e fatkeqësive të ndryshme natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut (p.sh. dëmtimi i objektit të banimit në rast fatkeqësie nga zjarri).

- c. Ndërtimi i dy objekteve në lagjen “Ali Ibra”, për strehimin e 28 njësive banesore

Sipas Planit Rregullues Urban vendbanimi joformal "Kolonia", planifikohen të ndërtohen edhe 2 objekte të banimit kolektiv me dimensione 11.00m’/17.00m’ dhe 21.00m’/8.00m’, këto dy objekte mundën të punohen edhe si një objekt i vetëm me etazhitet P+3.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Ky objekt i vetëm ka sipërfaqe të përgjithshme prej $S=2432.00 \text{ m}^2$, të zhvilluara me 28 njësi banimi, ku çmimi total për të dy objektet është $\sim 72,960.00 \text{ €}$.




FIGURA 10, REVIDIMI I PLANIT RREGULLUES I KOMPLEKSIT 'ALI IBRA'



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



FIGURA 11, KATI KARAKTERISTIK I OBJEKTIT KOLEKTIV TË BANIMIT SOCIAL



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. CM-51037 /2016

Dt. 23.12.2016

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 shkronja (k) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në nenin 14 shkronja (k) të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 20 pika 1.4 dhe nenit 25 pika 1.3, të Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e programeve të veçanta të banimit në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.12.2016, pas diskutimeve lidhur me pikën e 4-të të rendit të ditës: Kërkesë për miratimin e lokacionit për planifikimin - ndërtimin e objektit banimor shumë banesor me etazhitet të ulët për nevoja të banimit social dhe strehimit në kompleksin "Ali Ibra", e miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për planifikimin - ndërtimin e objektit banimor shumë banesor me etazhitet të ulët për nevoja të banimit social dhe strehimit në kompleksin "Ali Ibra"

1. Miratohet lokacioni për planifikimin - ndërtimin e objektit banimor shumë banesor me etazhitet të ulët për nevoja të banimit social dhe strehimit në kompleksin "Ali Ibra".
2. Lokacioni gjendet në pjesët e parcelave ku shtrihen dhe ndërlihen dy planet urbanistike të Kompleksit "Ali Ibra" i cili është i destinuar dhe pjesërisht i realizuar (mbi 70%) për strehimin e vendbanimit joformal Kolonia dhe riadhesimin e familjeve me karakter Social.
3. Lokacioni është pjesë e parcelës me nr.70705028-5023-2 Z.K. Gjakovë jashtë Qytet, në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.66.89 ha në pronësi të : P.S.H. Kuvendi i Komunës Gjakovë. Sipërfaqja hapësimore për vendosjen - locimin e dy objekteve është 1.400.60m² (00.14.0 ha), ndërsa sipërfaqja e përafër e dy objekteve është 580.00m² (11.0m² /17.0m² dhe 21.0m² /8.0m²). Këto dy objekte mundën të punohen edhe si një objekt i vetëm, dhe do të projektohen sipas normave banimore për banim social duke i ofruar disa tipologji të njësive banimore nga një dhomëshe deri në tri dhomëshe.
4. Objekti i planifikuar do të ketë katësi të ulët deri në P+3, me numri të përgjithshëm të njësive banimore prej maksimum 28 njësi. Ky lokacion - objekt është i përfshirë në draft programin 3 vjeçar të veçantë të banimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.

6. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetares së Komunës;
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës;
- Arkivit;



Kryetari i Kuvendit të Komunës
Z. Ahmet Gola

FIGURA 12, VENDIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS MBI MIRATIMIN E LOKACIONIT PËR BANIM SOCIAL



12.2 BONUS BANIMI

Komuna e Gjakovës për momentin është duke i ndihmuar 5 familje me Bonus Banim. Për tre vitet në vijim planifikohen që të ndihmohen 25 familje, si më poshtë:

- 5 familje në vitin 2020 (buxheti për këto raste duhet të gjendet nga kodi për subvencione apo mallra dhe shërbime, meqenëse buxheti për vitin 2020 është miratuar dhe nuk ka kod të veçantë)
- 20 familje për vitet 2021 dhe 2022. Për këto familje kërkohet që buxheti të jetë i ndarë si nën kod i veçantë.

Kjo formë e ndihmës do të paguhet e tëra nga buxheti Komunal.

Vlera monetare e përafërt e kërkuar për këtë qëllim është si në vijim:

Viti 2020: 5 familje x 100 €/muaj x 12 muaj = 6000 €/vit

Viti 2021: 10 familje x 100 €/muaj x 12 muaj = 12,000 €/vit

Viti 2022: 10 familje x 100 €/muaj x 12 muaj = 12,000 €/vit

12.2.1 MËNYRA E IMPLEMENTIMIT

Për të ndihmuar këto familje, Komuna e Gjakovës do të shpall konkurs për të kërkuar nga bizneset apo personat juridik që të japin me qira banesat e tyre për bonus banim. Nëse nuk ka të interesuar atëherë përfituesit mund të zgjedhin vet se ku duan të vendosen ashtu që komuna do t'ua paguaj gjysmën e qerasë por jo më tepër se 100 € në muaj. Kontratat do të lëshohen një vjeçare dhe familjet do të duhet të aplikojnë për çdo vit.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



13 PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Për realizimin e Programit Tre-Vjeçar për Banim në Komunën e Gjakovës duhet që të bëhet planifikim buxhetor në bazë vjetore. Siç është cekur më lartë, përmes këtij programi Komuna e Gjakovës planifikon të ndihmojë 113 familje të cilat nuk janë në gjendje që me financim vetanak të sigurojnë banimin.

Nga Komuna e Gjakovës kërkohet që për nevoja të këtij programi në periudhën 2020-2022 të siguron buxhet në vlerë 1,203.822€. Në formë tabelare kjo ndarje duket si në vijim:

Mënyra e ndihmës	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Totali
Ndërtimi i dy ndërtesave (ose një e përbashkët) në lagjen "Ali Ibra" për strehimin e 28 familjeve.	/	/	/	72.960 €
Ndërtimi i dy objekteve në rrugën "Tirana" për strehimin e 60 familjeve	/	/	/	1.127.862€
Bonus-Banimi (pagesa e gjysmës së qirasë për familjet në nevojë për banim. Në këtë formë do të ndihmohen 25 familje;	6,000 €	12,000 €	12,000 €	30,000 €
Totali për vite:				1.203.822 €

TABELA 11, BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR BANIM SOCIAL PËR VITET 2019-2021

Për ndërtimet e banesave sociale, Komuna e Gjakovës do të participon në vlerë prej 20% nga vlera totale, pjesa tjetër do të kërkohet nga MMPH.



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO**
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



14 ANALIZA E FAKTEVE - PËRMBLEDHJE

1.	Qëllimi i hartimit të programit tre vjeçar	Qëllimi kryesor i përpilimit të Programit Tre-Vjeçar në Komunën e Gjakovës është që të ndihmohen familjet të cilat kanë nevojë për banim social e nuk kanë mundësi vetanake për të siguruar strehë mbi kokë.
2.	Baza ligjore	Ky program bazohet në legjislaturën ekzistuese të Republikës së Kosovës të përshkruar më detajisht në kapitujt e sipërm të këtij dokumenti. Sidoqoftë dy dokumentet kryesore janë Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (03/L - 164) dhe Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Ky program mundëson një lidhje organike midis mandatit 4 vjeçar të pushtetit lokal dhe projekteve komunale në fushën e banimit. Është i paraparë afati 3 vjeçar, të jetë me i përshtatshëm për të hartuar dhe për të dhënë në jetë programet e banimit, duke marr parasysh veçoritë e Komunës së Gjakovës si p.sh: politikat komunale të banimit (si veçoritë përkatëse), pozita gjeografike, demografike dhe institucionale.
3.	Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme	1. Banesat sociale; 2. Bonus banimi
4.	Prezantimi i gjendjes faktike	1. 48 familje janë të sistemuara në objektet e banimit social 2. 24 kërkesa zyrtare për banim social 3. 18 kërkesa për bonus banim (prej të cilave 5 janë përfituese)
5.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	A) Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale; B) Familjet që nuk posedojnë sipërfaqe banimi; C) Familjet që janë me kategori sociale, nënat vetushqyese; D) Të riatdhesuarit, kategoritë e mbetura pa shtëpi si pasojë e dëmtimeve gjatë luftës së fundit; E) Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike. F) Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO**
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



6.	Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës se trajtimeve te tyre	Përmes PTB, komuna synon që të ofron banim të qëndrueshëm për personat dhe familjet që nuk kanë fuqi ekonomike të marrin me qira banesë me çmim të tregut. Me këtë nuk pretendohet që brenda afatit prej tri vjetësh t'i plotësoj të gjitha kërkesat, por të veprohet hap pas hapi në mënyrë që me kapacitetet e veta modeste financiare dhe mbështetje eventuale nga niveli qendror, të zgjidhë sa më shumë çështje të banimit. Duke u bazuar në Ligjin në fuqi si dhe në Udhëzimet Administrative, Komisioni Komunal bënë identifikimin dhe përcaktimin e kërkesave urgjente për zgjidhje të çështjes së banimit dhe atyre për ndërtimin e banesave. Softueri për regjistrimin e përfituesve do të ndihmon shumë në këtë drejtim.
7.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	• Rivlerësimi i banesave sociale në rrugën "Tirana"; • Regjistrimi i aplikusëve; • Vendosja e tyre në Data Bazë; • Vizita në terren; • Krijimi i listës prioritare për ndihmë sipas mundësive buxhetore; • Zbatimi i programit me Bonus Banimi; • Nënshkrimi i kontratës me përfitues të banimit social; • Mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi të dedikuara për Banim Social;
8.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2020-2022
9.	Kornizën e shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë	Për çdo vit, komuna përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, duhet t'i ndan mjetet për ndërtim, renovim të shtëpive, duke iu referuar vlerësimit të komisionit, bazuar në kërkesat e qytetarëve.
10.	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	Planifikimi i buxhetit Donatorët Zyrtar i banimit Rekomandohet formimi i një zyreje për banim në Komunën e Gjakovës. Momentalisht është emëruar një zyrtar për banim i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e PTB.



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO**
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



11.	Mënyra e financimit të programeve tre vjeçare (të plotësohet më detajisht në dokumentin me programet trevjeçare të banimit)	Buxheti komunal Niveli qendror-MMPH,MPB,MPMS,MKK Donator
12.	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	Sipas informatave nga Drejtorati i Urbanizmit, është përfshirë ky lloj banimi në Dy Plane Rregulluese, të cilat ende nuk janë implementuar tërësisht: • Plani Rregullues Urban i rrugës “Tirana” – të planifikuara (të perealizuara edhe dy objekte të banimit kolektiv) dhe • Revidimi i Planit Rregullues Urban “Ali Ibra” – të planifikuara (të perealizuara edhe dy objekte të banimit kolektiv).
13.	Instrumentet mbikëqyrëse	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, Komisioni i themeluar (Grupi Punues) dhe Po ashtu themelimi i zyrës së banimit, do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara, që fillimisht i mundëson komunës që të ketë mbikëqyrje direkte në zbatimin e PTB.
14.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Monitorimi i procesit të zbatimit të programit, vlerësimi i treguesve të suksesit për afatin e paraparë të veprimit si dhe bërja transparente e këtij vlerësimi e garanton realizimin më të efektshëm të programit. Monitorimi është një mjet i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së zbatimit duke i adresuar dhe përshtatur ndryshimet dhe pengesat në proces. Përfshinë këto aktivitete: • Shkalla e suksesit të Programit në krahasim Planin e Veprimit; • Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore; • Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat); • Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë-harmonizimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



		Bërja publike e raporteve të vlerësimit e bënë edhe më të qëndrueshëm zbatimin e programit.
15.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analizë, debate publike me ekspert te ndryshëm, raportet, informatat nga rrjetet sociale etj. Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës, respektimi i kuadrit ligjor.



15 REZULTATET PAS ZBATIMIT

Programi për Banim është hartuar në mënyrë që të mund të zbatohet, të matet dhe të monitorohet. Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se ai siguron që veprimet janë zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut.



16 SEKTORIT I BANIMIT

Komuna e Gjakovës e ka emëruar një zyrtare për banim e cila do të jetë përgjegjëse për funksionimin e banimit social.

Përpilimi dhe aprovimi këtij programi tre vjeçar do të jetë udhërrëfyes për planifikimin e mirëfilltë të banimit social me çka do të ndihmohet një numër i caktuar i familjeve në një periudhë tre vjeçare.

Për nevoja të ndryshme që lidhen me zbatimin e këtij programi, zyrtarja për banim social do të inicion krijimin e komisioneve komunale.

Një ndër komisionet që do të krijohet është komisioni për rishqyrtimin e të gjitha 48 familjeve të cilat jetojnë në ndërtesa të banimit social në lagjen "Tirana".

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e komplet një sektori të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Sektori i banimit është një organ i përhershëm që planifikohet të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Ky sektor do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara për vitet në vijim. Sektori i banimit do të jetë organ i përhershëm që duhet të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit.

- Rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit,
- Mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Procesi i monitorimit do të përfshijë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit në krahasim me Planin e Veprimit,
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë.

16.1 INSTRUMENTET E MBIKËQYRJES

Deri sa nuk krijohet sektori i banimit, zyrtarja për banim e Komunës së Gjakovës do të jetë përgjegjëse për zbatimin e programit Tre Vjeçar për banim përmes krijimit të komisioneve të veçanta të cilat do ta rrisin transparencën dhe llogaridhënien.

Mbikëqyrja e programit do të bëhet nga Kuvendi Komunal i Gjakovës për të gjitha pikat sipas specifikacioneve të ligjit për financimin e programeve të veçanta për banim (03L-164)



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



17 ANALIZA SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË- MANGËSITË
✓ Ekzistimi i programit; ✓ Ekzistimi i zyrtares për banim; ✓ Plani zhvillimor/ Ndarja e truallit; ✓ Iniciativa për zgjidhjen e banimit; ✓ Planifikimi buxhetor; ✓ Të dhënat për nevojat e banimit; ✓ Ligji për programet e veçanta të banimit dhe udhëzimeve administrative; ✓ Strategjitë komunale; ✓ Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe ✓ Të dhënat e sakta për kërkuesit ✓ Programe të veçanta	✗ Mjete të pamjaftueshme buxhetore; ✗ Infrastruktura përcjellëse; ✗ Mirëmbajtja e objekteve të banimit social ✗ Kapacitetet jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social ✗ Mungesa e interesimit të grupeve tjera pjesëmarrëse
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Lista e kërkuesve; ➤ Lokacioni është i caktuar; ➤ Donatorët, ndihma nga MMPH; ➤ Identifikimi i banesave private që janë të lira; ➤ 5.Programe të përbashkëta me partner ndërkombëtar në fushën e banimit ➤ 6.Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit (banimit) ➤ 7.Themelimi i sektorit të banimit ➤ 8.Skemat garantues	○ Jo stabiliteti politik ○ Rritja e numrit të kërkesave; ○ Dëmtimet e paparashikuara gjatë asaj periudhe të banimit; ○ Mosrealizimi i programeve për mungesë të fondeve; ○ Niveli i lartë i varfërisë ○ Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare ○ Papunësia dhe mungesa e punësimit ○ Trendi i rritjes së numrit të popullsisë

Figura 13, SWOT ANALIZA



18 PËRFUNDIM

Komuna e Gjakovës, ka qenë në mesin e atyre komunave që asnjëherë deri më tash nuk a ka hartuar ndonjë Program për banim social të qytetarëve. Ka qenë nevojshme që edhe kjo komunë të harton një Program tre vjeçar për banim. Kështu, Kryetari i Komunës, ka marr vendim për formimin e komisionit i cili do të hartoj Programin 3 vjeçar për banim social dhe me këtë program të kemi të drejtë të konkurrojmë për ndonjë donacion për ndërtimin e një objekti social gjatë këtyre tre vjetëve. Nevoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm i Programit për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është e domosdoshme formimi i Sektorit të banimit si një organ përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvilloj procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe në Partneritet publiko-privat, që do të siguroj banim për grupe të caktuara, dhe t'iu dilet në ndihmë në strehimin e këtyre kategorive të marginalizuara.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga këto parime:

- përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit dhe banimit me qira joprofitabile ose në bonues të banimit për banesat me qira të ulët;
- Stimulimi i ofertës dhe kërkesës;
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave joprofitabile, zvogëlimin-kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit;
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i ndërtesave për banim social.



19 REFERENCAT

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës. *Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare*. [Online] 2011. <http://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf>..
2. Të dhënat kryesore. [Online] <http://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf>.
3. Te dhenat e popullsisë ne grupmoshat per nivele komunale. [Online] 2011. [http://mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_3b_-
_Te_dhenat_e_popullsisë_ne_grup_mosha_per_nivele_komunale.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_3b_-_Te_dhenat_e_popullsisë_ne_grup_mosha_per_nivele_komunale.pdf)..
4. Kosovës, Agjencia e Statistikave të. Te dhenat e popullsisë ne grupmoshat per nivele komunale. [Online] 2011. [http://mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_3b_-
_Te_dhenat_e_popullsisë_ne_grup_mosha_per_nivele_komunale.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_3b_-_Te_dhenat_e_popullsisë_ne_grup_mosha_per_nivele_komunale.pdf).